



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS

KRYETARI I KOMUNËS

nr. 044.020/04-0235807 më 20.09.2017
17

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L -040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008) dhe të dispozitave të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

I. Miratohet Vendimi për caktimin e grupit punues për hartimin e Rregullores për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale.

II. Grupi punues i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. Burbuqe Hydaverdi - Drejtorja e PSZhQ., kryesuese
2. Jehona Mavraj - Drejtorja e PSZhQ., anëtare
3. Fatbardha Mehmetukaj - Drejtorja e ShPMSH, anëtare
4. Anita Osmani - Drejtorja e Urbanizmit, anëtare
5. Ibrahim Morina - Drejtorja e Financave, anëtar
6. Ferit Fazliu - Drejtorja e Investimeve Kapitale, anëtar
7. Edona Bislimi - Sektori ligjor, anëtare

III. Grupi punues nga pika II të këtij vendimi, ka për detyrë hartimin e Rregullores për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale.

IV. Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Ju dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.



Kryetari i Komunës
Sjpend Ahmeti